



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 59

Tiranë – E martë, 1 prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 16/2025, datë 13.3.2025	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve lidhur me hapjen e përfaqësisë së Bankës Evropiane të Investimeve në Shqipëri..... 6545
Dekret i Presidentit nr. 101, datë 27.3.2025	Për shpallje ligji..... 6555
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 182, datë 20.3.2025	Për delegim kompetence..... 6555
Urdhër i ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin nr. 1, datë 13.3.2025	Për delegim kompetence..... 6555
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 269, datë 21.3.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 1101, datë 19.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”; urdhrit nr. 162, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës”; urdhrit nr. 10, datë 10.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”; urdhrit nr. 30, datë 13.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë”; urdhrit nr. 252, datë 13.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë”; urdhrit nr. 1021, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Austrisë”..... 6556
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 270, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë 6556

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 271, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë....	6557
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 272, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	6558
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 273, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	6559
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 274, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut.....	6560
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 275, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	6561
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 276, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike, të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	6563
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 277, datë 21.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Moldavisë.....	6565
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 278, datë 21.3.2025	Për shfuqizimin e urdhrin nr. 439, datë 25.7.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kosova” dhe për shfuqizimin e urdhrin nr. 976, datë 19.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Suedisë”	6568
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 281, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	6568
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 282, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Moldavisë....	6569
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 283, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	6570
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 284, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	6570
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 285, datë 25.3.2025	Për shfuqizimin e urdhrin nr. 308, datë 24.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Greqisë”, dhe për shfuqizimin e urdhrin nr. 477, datë 24.6.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”	6571

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 286, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë....	6571
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 287, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Rumanisë....	6572
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 288, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	6573
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 289, datë 25.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë.....	6575
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 20.2.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 596 (86-2023-878), datë 20.9.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1702, datë 11.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.....	6575



LIGJ
Nr. 16/2025

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
TË INVESTIMEVE LIDHUR ME HAPJEN
E PËRFAQËSISË SË BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE
NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve lidhur me hapjen e përfaqësisë së Bankës Evropiane të Investimeve në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2025.

Shpallur me dekretin nr. 101, datë 27.3.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS EVROPIANE TË
INVESTIMEVE LIDHUR ME HAPJEN E
PËRFAQËSISË SË BANKËS EVROPIANE TË
INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Republika e Shqipërisë (referuar në vijim “Shteti”) dhe Banka Evropiane e Investimeve (referuar në vijim “BEI”), një organizatë ndërkombëtare e pajisur me personalitet juridik dhe

organ i Bashkimit Evropian, themeluar në bazë të Traktatit për Funksionimin e BE-së, anëtarët e së cilës janë Shtetet Anëtare të BE-së (referuar në vijim së bashku “Palët”);

Me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e tyre dhe për të lehtësuar realizimin e objektivave të Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë;

Me dëshirën për të rënë dakord për kushtet në lidhje me hapjen, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të një Përfaqësie të BEI-t (në vijim referuar si “Përfaqësia”) dhe për privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për përmbushjen e misionit të saj;

Duke marrë parasysh Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, që rregullon aktivitetet e BEI-t në Shqipëri, nënshkruar në vitin 1998 (ligji nr. 8326, datë 9.4.1998), në Tiranë, dispozitat e së cilës nuk preken nga kjo Marrëveshje;

Duke pasur parasysh që Shteti njëh rëndësinë e hapjes së një Përfaqësie të BEI-t brenda territorit të tij;

Duke pasur parasysh se Përfaqësia e BEI-t dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian, ky i fundit i hapur më parë në Republikën e Shqipërisë, që përfshihen në të njëjtin kuadër ligjor, duke u udhëhequr nga rregullat ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet diplomatike dhe, veçanërisht, nga dispozitat ligjore të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, të datës 18 prill 1961 (në vijim referuar si “Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike e 1961”);

Duke konfirmuar se Shteti e ka në vëmendje që Përfaqësia e BEI-t, agjentët dhe punonjësit e saj dhe anëtarët e organeve të tij drejtuese do të përfitojnë, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nga një regjim që është të paktën i krahasueshëm me atë që i është dhënë Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe zyrtarëve, agjentëve dhe anëtarëve të tij;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Agjenti i Përfaqësisë” nënkupton Drejtuesin e Përfaqësisë, si dhe çdo agjent tjetër në distancë të caktuar nga BEI në Përfaqësi.

b) “Arkivi i Përfaqësisë” nënkupton të gjitha regjistrimet, korrespondencën, dokumentet dhe materialet e tjera, duke përfshirë dorëshkrimet,



fotografitë e palëvizshme dhe lëvizëse dhe regjistrimet filmike, programet kompjuterike dhe materialet e shkruara, videokasetat dhe disqet, si dhe disqet ose kasetat që përmbajnë të dhëna që i përkasin ose mbahen nga/ose në emër të Përfaqësisë.

c) *“Punonjësi i Përfaqësisë”* nënkupton personelin e rekrutuar në nivel lokal sipas instrumenteve të veçanta të parashikuara për punësimin e personelit jashtë zyrës kryesore të BEI-t dhe të caktuar në shërbimin e Përfaqësisë.

d) *“Organet drejtuese të BEI-t”* nënkupton Bordin e Guvernatorëve, Bordin e Drejtorëve dhe Komitetin Drejtues të BEI-t.

e) *“Shefi i Përfaqësisë”* nënkupton zyrtarin kryesor të Zyrës së Përfaqësisë, të emëruar nga BEI, duke përfshirë çdo zyrtar të emëruar për të kryer detyrat e zyrtarit kryesor gjatë mungesës së tij/saj.

f) *“Anëtar i familjes”* nënkupton: (i) bashkëshortin /en ose partnerin/en e jetës i njohur zyrtarisht si i tillë nga BEI; (ii) fëmija (fëmijët); dhe (iii) çdo anëtar tjetër i familjes, i njohur zyrtarisht si i varur nga BEI.

g) *“Pasuria dhe asetet e Përfaqësisë”* nënkupton të gjitha pronat dhe asetet që gëzon BEI në Përfaqësi ose të fituara nga Përfaqësia në Republikën e Shqipërisë.

h) *“Zyrat e Përfaqësisë”* nënkupton ndërtesën ose pjesët e një ndërtese dhe tokën, pavarësisht nga pronësia, e përdorur për qëllime zyrtare të Përfaqësisë. Ai përfshin gjithashtu rezidencën në Republikën e Shqipërisë të kryetarit të Përfaqësisë, si dhe të çdo agjenti tjetër të mërguar të caktuar nga BEI në Përfaqësi.

i) *“Protokoll i mbi privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Evropian”* nënkupton protokollin nr. 7, pjesë përbërëse e Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

j) *“Përfaqësia”* nënkupton Përfaqësinë e BEI-t në Republikën e Shqipërisë dhe përfshin zyrën kryesore në Tiranë dhe çdo zyrë shtesë që mund të krijohet me miratimin eksplicit të shtetit në vende të tjera në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Shteti pranon hapjen e përfaqësisë së BEI-t në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo Përfaqësi synon të sigurojë realizimin e aktiviteteve të BEI-t në Republikën e Shqipërisë.

Funksionet që do të realizohen nga Përfaqësia përfshijnë të gjitha aktivitetet që do të kryejë BEI, sipas statutit të saj dhe objektivave të përgjithshëm të BEI-t, në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian.

Neni 3

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, BEI ka status juridik.

BEI ka zotësi të plotë juridike dhe në veçanti për të lidhur kontrata, për të blerë dhe për të disponuar pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme dhe për të qenë palë në çdo proces gjyqësor ose administrativ dhe gjithashtu për të kryer çdo veprimtari tjetër të parashikuar në statutin e saj ose që ndjek drejtpërdrejt objektivat e përcaktuar në statutin e saj.

Neni 4

Prona, asetet dhe zyrat e Përfaqësisë, si dhe pronat dhe asetet e BEI-t, të çfarëdo lloji, pavarësisht se ku ndodhen dhe në posedim të kujt janë, përfshirë edhe Arkivin e Përfaqësisë, përjashtohet nga çdo lloj ndërhyrjeje, bastisje, konfiskimi, rekuizimi, shpronësimi apo çdo forme kontrolli apo vendosjeje të masave me ndonjë akt administrativ, legjislativ ose gjyqësor.

Shteti do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur zyrat e Përfaqësisë kundër çdo ndërhyrje apo dëmtimi dhe çdo akti që synon të prishë rendin publik brenda ambienteve të Përfaqësisë, në të njëjtat kushte si ato që u jepen misionëve diplomatike të akredituara në Shtet. BEI do t'i kalojë në kohë shtetit informacionin e nevojshëm në lidhje me situatën dhe gjendjen e ambienteve të Përfaqësisë.

Neni 5

BEI dhe Përfaqësuesit e tij mund të mbajnë në dispozicion të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë të gjitha llojet e fondeve dhe valutave të çdo lloji dhe të ndërmarrin çdo transaksion financiar, duke përfshirë veprimet e llogarive bankare në çdo valutë, të destinuara për arritjen e objektivave të saj në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

BEI gëzon lirinë për të transferuar fondet dhe monedhën e saj, si brenda Republikës së Shqipërisë,



ashtu edhe nga një vend në tjetrin, si dhe të konvertojë çdo monedhë që zotëron. Ajo, gjithashtu, do të përjashtohet nga detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e aseteve dhe objekteve, përfshirë mjetet motorike, të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve të saj, të cilat janë subjekt i parashikimeve të rregullave të brendshme për privilegjet dhe imunitetet diplomatike.

BEI, të ardhurat, pronat dhe asetet e saj, si dhe veprimet dhe transaksionet e kryera prej saj në përputhje me statutin e saj, do të përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave, tarifave fiskale, detyrimeve doganore dhe detyrimeve të natyrës së ngjashme. Ajo, gjithashtu, do të përjashtohet nga çdo formë përgjegjësie në lidhje me pagesën, mbajtjen ose mbledhjen e çdo takse, tarife ose detyrimi dhe pagesën e tarifave për mirëmbajtjen e autostradave publike. Këto përjashtime nuk do të zbatohet për pagesat e stafit lokal.

Neni 6

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, BEI, Përfaqësia e saj, agjentët dhe punonjësit e Përfaqësisë dhe anëtarët e organeve drejtuese të BEI-t, si dhe familjarët e personave të sipërpërmendur, në përputhje me dispozitat e *Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961*, duhet të gëzojnë të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato që u jepen misioneve diplomatike të akredituara në Shtet, krerëve dhe anëtarëve të stafit të tyre, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Në këtë mënyrë evidentohet se, në përputhje me nenin 16 të *Protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Evropian*, Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe të BEI-t u japin të njëjtat privilegje dhe imunitete diplomatike misionit të shtetit për Bashkimin Evropian, kreut të tij, anëtarëve të stafit, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Privilegjet dhe imunitetet e dhëna nga Shteti në përputhje me paragrafin e mësipërm nuk do t'u jepen personave që janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, përveç me pëlqimin e veçantë të Shtetit.

Neni 7

Shteti do të njohë *laissez-passer* të lëshuar nga Bashkimi Evropian për agjentët e BEI-t dhe për anëtarët e organeve drejtuese të BEI-t, në përputhje

me nenin 6 të *Protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Bashkimit Evropian*, si dokument i vlefshëm udhëtimi.

Shteti, i vetëdijshëm për aspektet ndërkombëtare të funksioneve që i atribuohen Përfaqësisë që shkojnë përtej territorit të Republikës së Shqipërisë, do të lehtësojë hyrjen dhe daljen nga territori kombëtar për të gjithë personat që janë të ftuar në takime, aktivitete ose punë të organizuara nga Përfaqësia. Palët mund të lidhin marrëveshje specifike për këtë qëllim. Kjo dispozitë është pa cenuar zbatimin e dispozitave specifike që lidhen me sigurinë kombëtare ose shëndetin publik.

Neni 8

1. Paga dhe shpërblimet e tjera të agjentëve dhe punonjësve të Përfaqësisë do të përjashtohen nga taksat, tarifat, ngarkesat dhe kontributet e veçanta, duke përfshirë regjistrimet tek autoritetet e sigurimeve shoqërore. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, konsulentët ose personat e tjerë që ofrojnë shërbime për Përfaqësinë, të cilët janë rezidentë për qëllime tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Agjentët dhe punonjësit e Përfaqësisë që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë do të përjashtohen nga taksat doganore për të gjitha objektet e përdorimit personal, si automjetet motorike, pajisjet shtëpiake dhe objektet personale në të njëjtat kushte si personeli diplomatik i njohur në Republikën e Shqipërisë.

3. Agjentët dhe punonjësit e Përfaqësisë që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtë që gjatë ushtrimit të funksionit dhe menjëherë pas ndërprerjes së misionit të tyre, të transferojnë fondet në çdo monedhë jashtë Republikës së Shqipërisë, pa kufizime, duke provuar që i zotërojnë këto fonde në mënyrë ligjore.

4. BEI do të informojë Republikën e Shqipërisë për identitetin e agjentëve dhe punonjësve të Përfaqësisë, si dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, për të cilët zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

1. Për të gjitha çështjet, që nuk parashikohen shprehimisht në këtë Marrëveshje dhe për interpretimin e saj, Palët bien dakord të zbatojnë *Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike e 1961*



dhe dispozitat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare.

2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të jetë objekt konsultimi ndërmjet Palëve, me synimin për të arritur një zgjidhje miqësore. Në rast të jashtëzakonshëm që një zgjidhje e tillë nuk është e mundur brenda një periudhe të arsyeshme, çështja do t'i referohet një arbitri të pavarur të caktuar me marrëveshje ndërmjet Palëve. Në rast të dështimit të arritjes së një marrëveshjeje për emrin e arbitrit brenda një periudhe prej një muaji, ky i fundit emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë. Një arbitrazh i tillë, vendimi i të cilit do të jetë detyrues, do të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme për Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit të Hagës. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi dhe gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykatës do të jetë anglishtja.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga BEI të njoftimit të dhënë nga Shteti, që

konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme dhe veçanërisht ratifikimin, i nevojshëm në Republikën e Shqipërisë për miratimin përfundimtar të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët mund ta ndryshojnë këtë Marrëveshje me pëlqim reciprok, të formalizuar me anë të komunikimeve me shkrim. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje është me kohëzgjatje të pacaktuar, përveç rastit kur njëra nga Palët, me njoftim me shkrim, vendos të përdorë fuqinë për ta përfunduar atë. Në çdo rast të tillë, Marrëveshja do të mbetet në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit për përfundimin e saj.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, të shkruar në 2 (dy) origjinale autentike, në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Nënshkruar në [Tiranë], më [24 janar] në vitin dy mijë e njëzet e [pesë] (2025).

PËR REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË

PËR BANKËN EVROPIANE
TË INVESTIMEVE



AGREEMENT
BETWEEN
THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
THE EUROPEAN INVESTMENT BANK
REGARDING
THE ESTABLISHMENT OF THE REPRESENTATION
OF THE EUROPEAN INVESTMENT BANK TO ALBANIA

The Republic of Albania (hereafter, “the State”) and the European Investment Bank (hereafter, “the EIB”), an international organisation vested with legal personality and a body of the European Union, established under the Treaty on the Functioning of the EU, the members of which are the Member States of the EU, (together, “the Parties”);

WISHING to strengthen their relations and to facilitate the realisation of European Union objectives in the Republic of Albania;

WISHING to agree on the terms concerning the establishment, within the territory of the Republic of Albania, of a Representation of the EIB (hereafter “the Representation”) and on the privileges and immunities necessary to the fulfilment of its mission;

CONSIDERING the Framework Agreement between the Republic of Albania and the EIB, governing EIB activities in Albania, signed in 1998 in Tirana, the provisions of which are not affected by the present Agreement;

CONSIDERING that the State recognises the importance of establishing a Representation of the EIB within its territory;

CONSIDERING that the Representation of the EIB, and the Delegation of the European Union, the latter having been previously established in the Republic of Albania, fall within the same legal framework, being governed by the international rules regulating diplomatic relations and more particularly by the legal provisions of the Vienna Convention of 18 April 1961 on Diplomatic relations (hereafter, “the 1961 Vienna Convention on Diplomatic relations”);

CONFIRMING that the State considers that the Representation of the EIB, its Agents and Employees and the members of its Governing bodies shall benefit, by virtue of the present Agreement, from a regime that is at least comparable to that granted to the Delegation of the European Union and to its officials, agents and members;



HAVE AGREED AS FOLLOWS:

Article 1

For the purpose of the present Agreement:

- a) “*Agent of the Representation*” means the Head of the Representation as well as any other expatriated agent assigned by the EIB to the Representation.
- b) “*Archives of the Representation*” means all records, correspondence, documents and other materials, including manuscripts, still and moving pictures and film recordings, computer programs and written materials, video tapes and discs as well as discs or tapes containing data belonging to or held by or on behalf of the Representation.
- c) “*Employee of the Representation*” means the staff recruited locally under separate instruments provided for the employment of personnel outside the principal office of the EIB and assigned to the service of the Representation.
- d) “*Governing bodies of the EIB*” means the Board of Governors, the Board of Directors and the Management Committee of the EIB.
- e) “*Head of the Representation*” means the principal official of the Representative Office, appointed by the EIB, including any official appointed to perform the principal official's duties during his/her absence.
- f) “*Family Member*” means (i) the spouse or the life partner officially recognised as such by the EIB; (ii) the child(ren) and (iii) any other family member, officially recognised as a dependant by the EIB.
- g) “*Property and Assets of the Representation*” means all property and assets vested by the EIB in the Representation or acquired by the Representation to the Republic of Albania.
- h) “*Premises of the Representation*” means the building or parts of a building and the land, irrespective of ownership, used for the official purposes of the Representation. It also includes the residence in the Republic of Albania of the Head of the Representation as well as of any other expatriated agent assigned by the EIB to the Representation.
- i) “*Protocol on the Privileges and Immunities of the European Union*” means the Protocol n°7 as annexed to the Treaty on the European Union and Treaty on the Functioning of the European Union.
- j) “*Representation*” means the Representation of the EIB to the Republic of Albania and includes the principal office in Tirana, and any additional office that may be established with the explicit approval of the State in other locations in the Republic of Albania.

**Article 2**

1. The State agrees to the establishment, within the territory of the Republic of Albania, of an EIB Representation. This Representation is intended to ensure accomplishment of the activities of the EIB in the Republic of Albania.
2. The functions performed by the Representation concern all activities carried out by the EIB, pursuant to its Statute and the EIB's objectives in general, in accordance with European Union policies.

Article 3

1. In the territory of the Republic of Albania, the EIB has legal personality.
2. The EIB has full legal capacity and in particular capacity to conclude contracts, acquire and dispose of immovable and movable property and be a party to any judicial or administrative proceedings and also to carry out any other activity provided for in its Statute or directly pursuing the objectives laid down in its Statute.

Article 4

1. The Property and Assets and the Premises of the Representation and the property and assets of the EIB, of any kind whatsoever, regardless of where they are located and in whose possession they are, including the Archives of the Representation, shall be exempt from any kind of intrusion, search, confiscation, requisition, expropriation or any form of control or attachment by any administrative, legislative or judicial act.
2. The State shall adopt all necessary measures to protect the Premises of the Representation against any intrusion or damage and any act intended to upset public order within the Premises of the Representation on the same terms as those afforded to diplomatic missions accredited to the State. The EIB shall in due time pass to the State the requisite information concerning the situation and characteristics of the Premises of the Representation.

Article 5

1. The EIB and its Representation may keep at their disposal in the territory of the Republic of Albania all manner of funds and currencies of any kind and undertake any financial transaction, including the operations of bank accounts in any currency, intended for the attainment of its objectives in accordance with the provisions of the present Agreement.
2. The EIB shall enjoy freedom to transfer its funds and currencies, both within the Republic of Albania and from one country to another, and to convert any currency in its possession. It shall likewise be exempt from customs duties,



prohibitions and restrictions on the import and export of the assets and objects, including motor vehicles, required for the pursuit of its activities, subject to the provisions of the internal rules on diplomatic privileges and immunities.

3. The EIB, its income, property, and assets, and, likewise the operations and transactions carried out by it in accordance with its Statute, shall be exempt from all manner of taxes, fiscal levies, customs duties and imposts of a similar nature. It shall likewise be exempt from any form of liability relating to the payment, retention or collection of any tax, levy or duty and the payment of charges for the upkeep of public highways. These exceptions shall not be applied for the payment of the local staff salaries.

Article 6

1. In the territory of the Republic of Albania, the EIB, its Representation, the Agents and Employees of the Representation and the members of the Governing bodies of the EIB, as well as the Family Members of the abovementioned persons, shall, enjoy the same privileges and immunities as those granted to diplomatic missions accredited to the State, the heads thereof and the members of their staff as well as the members of their families laid down by the *Vienna Convention on Diplomatic relations of 1961*. It is hereby placed on record that, pursuant to Article 16 of the *Protocol on the Privileges and Immunities of the European Union*, the Member States of the European Union and of the EIB grant the same diplomatic privileges and immunities to the mission of the State to the European Union, the Head thereof, the members of its staff as well as to the members of their families.
2. The privileges and immunities granted by the State in accordance with the foregoing paragraph shall not be granted to persons who are nationals of the Republic of Albania, except with the specific consent of the State.

Article 7

1. The State shall recognise the *laissez - passer* issued by the European Union to the agents of the EIB and to the members of the Governing bodies of the EIB, in accordance with Article 6 of the *Protocol on the Privileges and Immunities of the European Union*, as a valid travel document.
2. The State, aware of the international aspects of the functions attributed to the Representation which go beyond the territory of the Republic of Albania, shall facilitate entry to and departure from its national territory for all persons who are invited to meetings, activities or work organised by the Representation. The Parties may conclude specific agreements for that purpose. This provision is without prejudice to the application of specific provisions related to national security or public health.



Article 8

1. The salary and other remuneration of the Agents and Employees of the Representation shall be exempt from levies, taxes, charges and special contributions, including subscriptions to social security authorities. This exemption shall not apply to nationals of the Republic of Albania, consultants or other persons providing services to the Representation who are resident for tax purposes in the Republic of Albania.
2. The Agents and Employees of the Representation who are not nationals of the Republic of Albania shall be exempt from customs duties on all objects of personal use such as motor vehicles, household equipment and personal objects on the same terms as diplomatic staff recognised in the Republic of Albania.
3. The Agents and Employees of the Representation who are not nationals of the Republic of Albania shall be entitled, during the exercise of their functions and immediately after ceasing to perform them, to transfer funds in any currency outside the Republic of Albania, without restriction or limitation, provided that they can prove legal possession of such funds.
4. The EIB shall inform the State of the identity of the Agents and Employees of the Representation, as well as of their Family Members, to whom the provisions of this Agreement apply.

Article 9

1. For all matters not expressly provided for in the present Agreement and for the interpretation thereof, the Parties agree to apply the *1961 Vienna Convention on Diplomatic relations* and the relevant provisions of international law.
2. Any difference which may arise regarding the interpretation and application of the provisions of this Agreement shall be the subject of consultation between the Parties with a view to reaching an amicable settlement. In the extraordinary event that such settlement is not possible within a reasonable period, the matter shall be referred to an independent arbitrator designated by agreement between the Parties. Failing such agreement as to the name of the arbitrator within a period of one month, the latter shall be appointed by the Secretary General of the Permanent Court of Arbitration in The Hague. Such arbitration, the award resulting from which shall be binding, shall be conducted in accordance with the legal provisions applicable to the Permanent Court of Arbitration of The Hague. The place of arbitration shall be Paris and the language to be used in the proceedings of the tribunal shall be English.

**Article 10**

1. The present Agreement shall enter into force on the date of receipt by the EIB of the notice given by the State confirming completion of the internal procedures, and especially ratification, required in the Republic of Albania for definitive approval of the present Agreement.
2. The Parties may amend the present Agreement by mutual consent, formalised by means of written communications. The amendments shall enter into force in accordance with paragraph 1 of this article.
3. The present Agreement shall be of indefinite duration unless either of the Parties, by giving written notice, decides to avail itself of the power to repudiate it. In any such case, the Agreement shall remain in force for six months following the date of receipt of the notice of repudiation.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned, duly authorised to this effect, have signed this Agreement, written in two (2) authentic originals, in the Albanian and English language. In case of differences in interpretation, the English text shall prevail.

Done at [TIRANA] this [24] day of [January] in the year two thousand and twenty [five] (2025).

**FOR
THE REPUBLIC OF ALBANIA**

**FOR
THE EUROPEAN INVESTMENT
BANK**



DEKRET
Nr. 101, datë 27.3.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 16/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, lidhur me hapjen e përfaqësisë së Bankës Evropiane të Investimeve në Shqipëri”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 182, datë 20.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”; të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 21.3.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 1, datë 13.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 22, pika 3, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, znj. Arlinda Hoti, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Trajnimit dhe Komunikimit, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

2. Delegimi i kompetencave të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe të mbarojë me shfuqizimin e tij me emërimin e titullarit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

3. Ngarkohet znj. Arlinda Hoti, drejtor i Drejtorisë së Trajnimit dhe Komunikimit, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHTETIT PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN**
Adea Pirdeni



URDHËR

Nr. 269, datë 21.3.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 1101, DATË 19.12.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E KROACISË”; URDHËRIT NR. 162, DATË 21.2.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E BELGJIKËS”; URDHËRIT NR. 10, DATË 10.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E FRANCËS”; URDHËRIT NR. 30, DATË 13.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E SLLOVAKISË”; URDHËRIT NR. 252, DATË 13.3.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E SUEDISË”; URDHËRIT NR. 1021, DATË 26.11.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E AUSTRISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1101, datë 19.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”; urdhrit nr. 162, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës”; urdhrit nr. 10, datë 10.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”; urdhrit nr. 30, datë 13.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë”; urdhrit nr. 252, datë 13.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë”; urdhrit nr. 1021, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Austrisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 270, datë 21.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHETETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland*
Bayern	Augsburg (Kreisfreie Stadt)	Augsburg*
Bayern	Garmisch-Partenkirchen	Ohlstadt*
Rheinland-Pfalz	Rhein-Pfalz-Kreis	Dannstadt-Schauernheim*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Altenpleen*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock (Kreisfreie Stadt)	Rostock*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Stralsund*
Baden-Württemberg	Schwäbisch Hall	Ilshofen-Vellberg*
Niedersachsen	Aurich	Aurich*
Niedersachsen	Friesland	Wangerland*
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren*
Brandenburg	Oberhavel	Zehdenick*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Landhagen*
Sachsen	Leipzig	Grimma*
Bayern	Ansbach	Feuchtwangen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 223, datë 6.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 271, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2
Héres	Fűzesabony*
Bács-Kiskun	Kiskőrös*
Békés	Mezőkovácsháza*



<i>Bács-Kiskun</i>	<i>Kiskunmajsza*</i>
<i>Csongrád-Csanád</i>	<i>Kistelek*</i>
<i>Pest</i>	<i>Cegléd*</i>

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 205, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 272, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

65°C në 39.8 sekonda;

70°C në 3.6 sekonda;

74°C në 0.5 sekonda;

80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Mazowieckie	Siedlce	Przesmyki*
3	Mazowieckie	Łosice	Łosice*
4	Podlaskie	Mońki	Mońki*
5	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
6	Podlaskie	Mońki	Krypno (Trzcianne)*
7	Podlaskie	Sokółka	Janów*
8	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
9	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
10	Podlaskie	Siemiatycze	Drohiczyn*
11	Podlaskie	Białystok	Wasilków*
12	Podlaskie	Sokółka	Korycin*
13	Podlaskie	Sokółka	Suchowola*
14	Podlaskie	Białystok	Łapy*
15	Mazowieckie	Łosice	Olszanka*
16	Mazowieckie	Łosice	Husław*
17	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)
18	Mazowieckie	Siedlce	Mordy*
19	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*



20	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
21	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
22	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
23	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
24	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
25	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Dąbrowa Biskupia*
26	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
27	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
28	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
29	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
30	Podlaskie	Łomża	Piątница*
31	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
32	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
33	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
34	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
35	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
36	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
37	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
38	Mazowieckie	Płońsk	Raciąż (rural)

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Urdhri nr. 227, datë 6.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave

Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 273, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3
1.	Łódzkie	Skiermiewice	Maków*
2.	Dolnośląskie	Trzebnica	Wisznia Mała*
3.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
4.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
5.	Wielkopolskie	Poznań	Kleszczewo*
6.	Wielkopolskie	Września	Miłosław*
7.	Dolnośląskie	Wolów	Wińsko*
8.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
9.	Śląskie	Częstochowa	Dąbrowa Zielona*
10.	Dolnośląskie	Góra	Niechlów*
11.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
12.	Mazowieckie	Siedlce	Zbuczyn*
13.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
15.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Dąbrówno*
16.	Łódzkie	Sieradz	Warta*
17.	Mazowieckie	Zuromin	Biezuń*
18.	Podkarpackie	Jarosław	Jarosław (rural)*
19.	Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
20.	Podkarpackie	Ropczyce-Sędziszów	Ostrów*
21.	Łódzkie	Kutno	Krośnice*
22.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Kisielice*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
24.	Łódzkie	Zgierz	Ozorków (rural)*
25.	Wielkopolskie	Koło	Grzegorzew*



26.	Wielkopolskie	Kępno	Kępno*
27.	Lubuskie	Nowa Sól	Kolsko*
28.	Wielkopolskie	Kalisz	Żelazków*
29.	Warmińsko-Mazurskie	Mrągowo	Piecki*
30.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
31.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
32.	Warmińsko-Mazurskie	Mrągowo	Mikołajki*
33.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
34.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Wielichowo*
35.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Kikół*
36.	Podkarpackie	Lesko	Olszanica*
37.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
38.	Małopolskie	Myślenice	Siepraw*
39.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Rakoniewice*
40.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Olsztynek*
41.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
42.	Wielkopolskie	Kościan	Czempiń*
43.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Janowiec Wielkopolski*
44.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
45.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
46.	Małopolskie	Tarnów	Wierzchosławice*
47.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
48.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
49.	Wielkopolskie	Krotoszyn	Koźmin Wielkopolski*
50.	Lubuskie	Świebodzin	Łagów*
51.	Mazowieckie	Mława	Lipowiec Kościelny*
52.	Wielkopolskie	Koło	Olszówka*
53.	Wielkopolskie	Jarocin	Kotlin*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 255, datë 13.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 274, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) mishit të freskët;
- ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- 65°C në 39.8 sekonda;
- 70°C në 3.6 sekonda;
- 74°C në 0.5 sekonda;
- 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.



Nga shteti i Maqedonisë së Veriut, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1
1.	Jegunovtse*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 275, datë 21.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faja zyrtare e OIE-s dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*
Adana	Kozan*
Adana	Aladağ*
Adana	Karaisali*
Afyon	Dazkırı*
Antalya	Merkez*
Malatya	Arguvan*
Karaman	Merkez*
Izmir	Dikili*
Izmir	Çiğli*
Izmir	Ödemiş*
Izmir	Güzelbahçe*
Izmir	Aliğa*
Kars	Kağızman*
Hakkari	Merkez*
Aydın	Sultanhisar*
Çankiri	Çerkeş*
Çankiri	Merkez*
Ankara	Bala*
Ankara	Polatlı*
Ankara	Elmadag*
Afyon	Sandıklı*
Aksara	Merkez*
Balıkesir	Bandırma*
Balıkesir	İvrindi*
Balıkesir	Merkez*
Bursa	Gemlik*
Erzurum	Tekman*
Erzurum	Çat*
Erzincan	Tercan*
Isparta	Uluborlu*
Karabük	Eflani*
Giresun	Yağlıdere*



Rize	Çamlhemşin*
Tokat	Zile*
Tokat	Başçıftlik*
Tokat	Erbaa*
Usak	Merkez*
Usak	Eşme*
Aydın	Köşk*
Çorum	Kargı*
Erzincan	Merkez*
Eskisehir	Beylikova*
Eskisehir	Seyitgazi*
Kütahya	Tavşanlı*
Bursa	Orhangazi*
Bursa	Orhaneli*
Çanakkale	Lapseki*
Agri	Doğubeyazıt*
Kütahya	Gediz*
Malatya	Yazıhan*
Tokat	Turhal*
Amasya	Taşova*
Amasya	Merzifon*
Burdur	Bucak*
Denizli	Bekilli*
Denizli	Honaz*
Elazığ	Palu*
Kastamonu	Merkez*
Samsun	Çarşamba*
Samsun	Tekkeköy*
Sivas	Yıldızeli*
Gaziantep	Nurdağı*
Kirsehir	Kaman*
Konya	Güneşsınır*
Konya	Çumra*
Sinop	Durağan*
Trabzon	Şalpazarı*
Samsun	Bafra*
Ordu	Korgan*
Konya	Sarayönü*
Manisa	Turgutlu*
Kocaeli	Gebze*
Kayseri	Kocasinan*
Isparta	Senirkent*
K. Maras	Türkoglu*
Izmir	Aliaga*
Eskisehir	Sivrihisar*
Elazığ	Keban*
Denizli	Bozkurt*
Bursa	Karacabey*
Çanakkale	Çan*
Eskisehir	Mihalıççık*
Elazığ	Merkez*
Eskisehir	Çifteler*
Eskisehir	Merkez*
Kayseri	İncesu*
Tokat	Niksar*
Tunceli	Çemişgezek*
Tunceli	Pertek*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta,

materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetohet se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3. Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetohet se këto produkte:



a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 173, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 276, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE,
TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;

b) materialit biologjik të pa shoqëruar me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, bashkëlidhur certifikatës shëndetësore veterinarë, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishin e freskët;

d) produktet e mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C për 30 minuta;

e) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë - kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

f) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të pa trajtuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

g) ushqim me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuara termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

Sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme të shtetit të Turqisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë
Sivas	Ulaş*
Sivas	Akıncılar*
Sivas	Yıldızeli*
Sivas	Altınyayla*
Sivas	Kangal*
Sivas	Doğanşar*
Sivas	Gürün*
Sivas	Merkez*
Sivas	İmranlı*
Diyarbakır	Merkez*
Konya	Kadınhanı*
Konya	Ereğli*
Tunceli	Pülümür*
Tunceli	Pertek*
Denizli	Çal*
Denizli	Çivril*
Erzurum	Şenkaya*
Erzurum	Çat*
Erzurum	Uzundere*
Erzurum	Hınıs*
Erzurum	Karaçoban*
Erzurum	Aşkale*
Erzurum	Tekman*
Erzurum	İlca*
Erzurum	İspir*
Afyon	Sandıklı*
Afyon	Dinar*
Afyon	Bolvadin*



Afyon	Sincanlı*
Afyon	Sultandagı*
Afyon	Merkez*
Afyon	İhsaniye*
Batman	Kozluk*
Isparta	Yalvaç*
Isparta	Keçiborlu*
Isparta	Gönen*
Isparta	Merkez*
Isparta	Şarkikaraağaç*
Izmir	Seferihisar*
Izmir	Bayındır*
Aydın	Germencik*
Aydın	İncirliova*
K. Maras	Elbistan*
Burdur	Merkez*
Burdur	Karamanlı*
Burdur	Bucak*
Aksaray	Eskil*
Aksaray	Güzelyurt*
Aksaray	Gülağaç*
Aksaray	Merkez*
Adana	Tufanbeyli*
Adana	Karataş*
Adana	Aladağ*
Trabzon	Maçka*
Rize	İkizdere*
Kütahya	Simav*
Kütahya	Aslanapa*
Kütahya	Emet*
Konya	İlgin*
Konya	Altınekin*
Konya	Tuzlukçu*
Konya	Derbent*
Kirsehir	Akpınar*
Kirsehir	Akçakent*
Kirsehir	Merkez*
Kayseri	Sanoğlu*
Kayseri	Yahyalı*
Kayseri	Akkışla*
Kayseri	Pınarbaşı*
Erzincan	Otlukbeli*
Erzincan	Üzümlü*
Iğdır	Karakoyunlu*
Bingöl	Yedisu*
Erzincan	Çayırli*
Erzincan	Tercan*
Erzincan	Otlukbeli*
Erzincan	Merkez*
Nevşehir	Kozaklı*
Nevşehir	Gülşehir*
Van	Erciş*
Mus	Bulanık*
Mus	Merkez*
Mus	Varto*
Malatya	Yazıhan*
Malatya	Merkez*

Mardin	Savur*
Kars	Arpaçay*
Kars	Merkez*
Kars	Sarıkamış*
Kars	Diğor*
Elazığ	Merkez*
Elazığ	Karakoçan*
Elazığ	Alacakaya*
Elazığ	Kovancılar*
Adıyaman	Gölbaşı*
Adıyaman	Gerger*
Nevşehir	Merkez*
Eskisehir	İnönü*
Eskisehir	Sivrihisar*
Agri	Merkez*
Agri	Tutak*
Hakkari	Merkez*
Siirt	Şirvan*
Van	Gürpınar*
Afyon	Dazkırı*
Van	Merkez*
Ankara	Bala*
Sanliurfa	Ceylanpınar*
Tunceli	Ovacık*
Gaziantep	Oğuzeli*
Iğdır	Merkez*
Iğdır	Aralık*
Kütahya	Tavşanlı*
Konya	Meram*
Erzurum	Merkez*
K. Maras	Pazarcık*
Adana	Karaisali*
Adana	Ceyhan*
Erzincan	Kemah*
Kayseri	Melikgazi*
Sanliurfa	Siverek*
Mugla	Milas*
Agri	Hamur*
Ardahan	Göle*
Erzurum	Narman*
Ardahan	Damal*
Kirsehir	Boztepe*
Batman	Beşiri*
Bitlis	Tatvan*
Elazığ	Palu*
Gaziantep	Şehitkamil*
Iğdır	Merkez*
Bingöl	Gence*
Gaziantep	Yavuzeli*
Karaman	Merkez*
Karaman	Ayrancı*
Nigde	Merkez*
Osmaniye	Kadirli*
Osmaniye	Sumbas*
Sivas	Gölova*
Sanliurfa	Merkez*
Eskisehir	Merkez*



Gaziantep	Şahinbey*
Aydin	Çine*
Ardahan	Merkez*
Afyon	İhsaniye*
Adiyaman	Merkez*
Adana	Saimbeyli*
Iğdır	Tuzluca*
Gümüşhane	Köse*
Konya	Karapınar*
Kars	Selim*
Kilis	Polateli*
Konya	Selçuklu*
Konya	Sarayönü*
Kütahya	Çavdarhisar*
Malatya	Darende*
Tunceli	Mazgirt*
Tunceli	Çemişgezek*
Tunceli	Hozat*
Mardin	Midyat*
Mersin	Mut*
Malatya	Arguvan*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, mielli i mishit, mielli i gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara dhe ushqimit të kafshëve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 163, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 277, datë 21.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një konteiner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë
Anenii Noi*
Briceni*
Cahul*
Chişinău*
Criuleni*
Dubăsari*
Drochia*
Edineţ*
Făleşti*
Floreşti*
Găgăuzia*
Rîşcani*
Sîngerei*
Străşeni*
Şoldăneşti*
Soroca*
Ialoveni*
Ocnîţa*
Ungheni*
Glodeni*
Donduseni*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.



2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Moldavisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të



Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1, ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 226, datë 6.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Moldavisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e



Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 278, datë 21.3.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 439, DATË 25.7.2023, “PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA KOSOVA” DHE PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 976, DATË 19.11.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E SUEDISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 439, datë 25.7.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kosova” dhe urdhrit nr. 976, datë 19.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Suedisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 281, datë 25.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Ukrainës, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
Sumy	Romens'kyi*
Kharkiv	Balakliis'kyi*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin



Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 138, datë 13.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 282, datë 25.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- dh) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Moldavisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1
1.	Leova*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 253, datë 13.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Moldavisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

**URDHËR****Nr. 283, datë 25.3.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, neni 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Holandës, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
2.	Friesland	Wûnseradiel*
3.	Noord-Brabant	Bladel*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 228, datë 6.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me

patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR**Nr. 284, datë 25.3.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Turqisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Konya	Selçuklu (Meram)*	
Afyon	Merkez*	
Konya	Çumra*	
Konya	Karatay*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 211, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 285, datë 25.3.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 308, DATË 24.4.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË”, DHE PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 477, DATË 24.6.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të Ligjit Nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i

Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 308, datë 24.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Greqisë”, dhe urdhrit nr. 477, datë 24.6.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 286, datë 25.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;



e) nënproduktet e shpendëve të patrajtuara termikisht.

Nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2
Yambol*	Tundzha*
Plovdiv	Asenovgrad*
Plovdiv	Rakovski*
Plovdiv	Sadovo*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 209, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 287, datë 25.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24 orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Rumanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
3	Tulcea	Tulcea*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1069, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me



patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 288, datë 25.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
TË DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN
E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*	Ndarja administrative e nivelit 3
Aegean	North Aegean	Lesbos*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Lokroi*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Orestiada*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Alexandroupoli*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Soufli*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Pangaio*

Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Emmanouil Pappas*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Maroneia-Sapes*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Didymoteicho*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Arriana*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Nestos*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Iasmos*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Komotini*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Abdera*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Xanthi*
Peloponez, Greqia Perëndimore dhe Ishujt Jon	Peloponez	Sikyona*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Rigas Feraios*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Topeiros*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Thasos*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Volvi*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Dorida*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Karystos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Mouzaki*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Volos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Tempi*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Notios Pilios*
Macedonia and Thrace	East Macedonia and Thrace	Kavala*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Tyrnavos*
Thessaly and Central Greece	Thessaly	Almyros*
Peloponnese, Western Greece and the Ionian Islands	West Greece	Missolonghi*
Peloponnese, Western Greece and the Ionian Islands	West Greece	Agrinio*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Sithonia*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Kymi-Aliveri*
Aegean	North Aegean	Lemnos*
Aegean	South Aegean	Andros*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Istiaia-Aidipsos*
Macedonia and Thrace	Central Macedonia	Dio-Olympos*



Thessaly and Central Greece	Central Greece	Mantoudi-Limni-Agia Anna*
Magnisia	Almyros*	
Xanthi	Topiros*	
Kavala	Kavala*	
Kavala	Nestos*	
Chalkidiki	Aristotelis*	
Aitolokarnania	Agrinio*	
Evros	Alexandroupoli*	
Rodopi	Maronia-Sapes*	
Evros	Samothraki*	
Iraklio	Archanes-Asterousia*	
Evros	Didymoticho*	
Rodopi	Komotini*	
Fokida	Dorida*	
Evia	Skyros*	
Aitolokarnania	Nafpaktia*	
Thessaloniki	Volvi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pafektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1. Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose të dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditë e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose të dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

ç) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2. Për spermën e cjepeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së

dhenve ose të dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe të dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe të dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

ç) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen, gjithashtu, në certifikatë).

2.3. Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe të dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Urdhri nr. 151, datë 19.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 289, datë 25.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24 orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Çekisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Plzeňský	Plzeň – jih*
2.	Středočeský	Mladá Boleslav*
3.	Jihomoravský	Znojmo*
4.	Kraj Vysočina	Jihlava*
5.	Pardubický	Ústí nad Orlicí*
6.	Ústecký	Teplička*
7.	Středočeský	Praha – východ*
8.	Plzeňský	Rokycany*
9.	Prague	Praha 19*
10.	Plzeňský	Tachov*

Shtënimet: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojnë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve

të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 210, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Çekisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 7, datë 20.2.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.2.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli dhe Nikolin Mhilli, përfaqësuar nga avokat Erdi Prifti, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, në mungesë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, përfaqësuar nga drejtor Granit Korbi.



AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Valbona Legisi, Juliana Çoma dhe Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 596 (86-2023-878), datë 20.9.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1702, datë 11.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 23, 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkuësve Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli dhe Nikolin Mhilli, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Shkodër (*Drejtoria Vendore e Kadastrës*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit tjetër të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli dhe Nikolin Mhilli janë në marrëdhënie familjare me njëri - tjetrin, përkatësisht prindër dhe fëmijë. Ata, në vitin 2014, në cilësinë e blerësve, kanë lidhur dy kontrata shitblerjeje me tre familjarë të afërm të tyre, në cilësinë e shitësve, me anë të të cilave kanë fituar të drejtën e pronësisë për dy pasuri të paluajtshme, të llojit tokë pemtore, me sipërfaqe 5038 m² dhe 353 m², të ndodhura në Pukë.

Kontratat e shitblerjes janë regjistruar rregullisht në regjistrin publik pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Pukë.

2. Me urdhrin nr. 471, datë 16.2.2015, ZVRPP-ja, Pukë, bazuar në nenet 59, 75, pika 2, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shfuqizuar (ligji nr. 33/2012), ka vendosur kufizimin e dy pasurive deri në plotësimin nga kërkuësit të dokumentacionit tekniko-ligjor që ka të bëjë me regjistrimin fillestar të tyre në pronësi të shitësve, me arsyetimin se punonjësit e saj kishin kryer gabim njerëzor, duke konsideruar titull pronësie të vlefshëm për regjistrim një vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së shitësve.

3. Kërkuësit kanë ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin, pavlefshmërinë absolute ose relative të urdhrit të kufizimit, si dhe heqjen e kufizimit për të dyja pasuritë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 553, datë 21.7.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë. Edhe pse kërkuësit kanë paraqitur ankim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 596 (86-2023-878), datë 20.9.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1702, datë 11.4.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve.

4. Në datën 4.6.2024 kërkuësit, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 5.6.2024.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 30.7.2024, ka vendosur kthimin e kërkesës, duke kërkuar plotësimin e të metave që lidheshin me shterimin e mjeteve juridike për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe me natyrën kushtetuese të pretendimeve të tjera. Kërkuësit, brenda afatit 30-ditor, konkretisht në datën 19.8.2024, i kanë plotësuar të metat, duke paraqitur informacione dhe dokumentacione shtesë.

6. Kolegji i Gjykatës, në datën 23.9.2024, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 2.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.



7. Në datën 7.2.2019 është miratuar ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me të cilin kompetencat e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme i kanë kaluar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës në të cilën janë kryer veprimet nga ata.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

8.1. *E drejta e informimit*, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi ZVRPP-ja, Pukë për kufizimin e vendosur për pasuritë ka njoftuar vetëm një nga kërkuesit, ndërsa nuk ka informuar tre të tjerët.

8.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 të Kushtetutës, pasi pasuritë e tyre janë ende të kufizuara, kufizimi ka tejkaluar afatin ligjor 30-ditor dhe është i pavlefshëm.

8.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.3.1. *E drejta e aksesit substancial* e lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë dhe ajo e apelit nuk kanë shqyrtuar pretendimet kryesore që lidheshin me zgjatjen e kufizimit për pasuritë tej afatit ligjor 30-ditor dhe me mungesën e njoftimit të të gjithë kërkuesve për kufizimin. Gjykatat kanë interpretuar gabim ligjin material dhe atë procedural. Gjykata e apelit ka arsyetuar vetëm për pavlefshmërinë absolute të kufizimit, duke mos u shprehur tërësisht për objektin e padisë, si dhe i është referuar një ligji, i cili nuk kishte hyrë ende në fuqi. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos e konsideruar se çështja kishte rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

8.3.2. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykimi i çështjes së kërkuesve në gjykatën e shkallës së dytë ka tejkaluar afatin ligjor 30-ditor dhe ka zgjatur më shumë se 7 vjet.

9. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për informim* është i pabazuar, pasi kërkuesi Tonin Mhilli, siç

parashtrohet edhe në rekurs, në datën 17.2.2015 është njoftuar për vendosjen e kufizimit të pasurive deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

9.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është haptazi i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme. Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe as interpretimin e ligjit që u përket gjykatave të zakonshme.

9.3. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi vendimet e kundërshtuara përmbushin standardet kushtetuese. Gjykata e zakonshme nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur, por nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura për çështjen. Ndërsa arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk e cenon procesin e rregullt ligjor.

9.4. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Ata, siç e pranojnë edhe vetë, nuk i janë drejtuar paraprakisht gjykatave të zakonshme për konstatimin e shkeljes sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

10. **Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore e Kadastrës**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1. Kërkimi për konstatimin e cenimit të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi nuk është ngritur përpara Gjykatës së Lartë, në bazë të parashikimeve të KPC-së, duke mos shteruar mjetet juridike efektive.

10.2. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë rrjedhojë e *një procesi të rregullt ligjor*, ndaj pretendimet e kërkuesve lidhur me të janë të pabazuara.

11. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,



shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar.

14. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket ankimeve për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijuese të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 2 datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuessit, ndër të tjera, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me argumentin se gjykimi i çështjes së

tyre në gjykatën e shkallës së dytë ka zgjatur për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar afatin ligjor 30-ditor. Gjithashtu, ata kanë pohuar se nuk kanë kërkuar në gjykatat e zakonshme konstatimin e shkeljes sipas dispozitave të KPC-së me argumentin se, shprehimisht, sipas tyre “*Dihet botërisht që Gjykata e Lartë nuk merr në konsideratë përsheptimin e gjykimit të çështjeve*”. Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Kadastrës, kanë prapësuar se ky pretendim nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuessit nuk kanë shfrytëzuar paraprakisht mjetin juridik të KPC-së, i cili ka hyrë në fuqi në datën 5.11.2017, pra gjatë kohës që çështja e tyre ishte ende në shqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë.

16. Gjykata vëren se argumenti i kërkuessve për qëndrimin refuzues të Gjykatës së Lartë ndaj kërkesave të tilla është paraqitur në mënyrë të përgjithshme, për këtë arsye është i pamjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin se kërkesa për konstatimin e shkeljes sipas neneve 399/1 e vijuese të KPC-së është mjet joefektiv për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim për shkak se kërkuessit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata konstaton se kërkuessit i janë drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë e kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis* Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 11.4.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 4.6.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae* kërkuessit kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t’u informuar, të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, me argumentin se urdhri për kufizimin e pronës nuk i është njoftuar individualisht të gjithë kërkuessve, por vetëm njërit nga ata (kërkuessit Tonin Mhilli). Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi është i pabazuar, pasi



njoftimi vetëm i kërkuarit Tonin Mhilli për kufizimin e pronës është i mjaftueshëm.

20. Gjykata vëren se neni 23 i Kushtetutës garanton në thelb të drejtën e kujtudo, që në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore (*pika 2*), si dhe mundësinë të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive (*pika 3*). Gjykata ka pohuar se e drejta e informimit është e drejta themelore për të marrë dhe dhënë informacion, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e informimit është e lidhur objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik dhe shërben si mjet i rëndësishëm dhe efikas për të kontrolluar demokracinë si formë qeverisjeje (*shih vendimin nr. 56, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke analizuar pretendimet e kërkuarve në kontekstin e garancive që përcakton neni 23 i Kushtetutës, Gjykata vëren se argumenti i tyre për mungesën e njoftimit nga ZVRPP-ja, Pukë nuk lidhet me të drejtën e informimit. Kjo e fundit, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës përfshin të drejtën e individit, që në përputhje me ligjin, të aksesojë fakte dhe të dhëna që lidhen me ushtrimin e pushtetit publik, në mënyrë që individit i informuar të ketë mundësinë të marrë pjesë në jetën publike. Në thelb, njohja e individit me informacion e ndihmon atë të formojë pikëpamje për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, ndërsa autoritetet publike i nxit në drejtim të integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuarve nuk ka të bëjë me të drejtën e informimit *per se*, por lidhet, në thelb, me procesin administrativ të kufizimit të pronës, në drejtim të së drejtës së njoftimit, e cila siç është theksuar në jurisprudencën kushtetuese, u paraprin të drejtave të tjera që garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë atë për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më lart, Gjykata konstaton se kërkuarët, të cilët në regjistrin e pasurive të paluajtshme figurojnë bashkëpronarë për pasuritë e kufizuara nga ZVRPP-ja, Pukë, edhe pse nuk kanë marrë të gjithë njoftim individual, nuk rezultojnë të jenë penguar për të paraqitur ankim në gjykatë ndaj aktit administrativ për kufizimin e pasurive, bazuar në njoftimin individual që kishte marrë vetëm kërkuari Tonin Mhilli. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e njoftimit individual për tre kërkuarët e tjerë nuk e ka bërë procesin të parregullt, në kuptimin kushtetues. Me të njëjtin arsyetim Gjykata çmon se është haptazi i pabazuar edhe pretendimi i kërkuarve se gjykatat e zakonshme, duke mos u dhënë përgjigje për këtë pretendim, u kanë cenuar atyre të drejtën e aksesit substancial. Kjo e fundit nuk duhet të kuptohet se përfshin detyrimin e gjykatave të zakonshme për përgjigje të detajuar dhe të shprehur për çdo pretendim të paraqitur nga palët, përveçse kur pretendimi është përcaktues për zgjidhjen e çështjes. Ashtu siç ka theksuar Gjykata në jurisprudencën e saj, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Më tej, Gjykata vëren se kërkuarët kanë pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private të fituar nëpërmjet kontratave të shitblerjes, për të cilat ata disponojnë certifikata të rregullta pronësie, për shkak të kufizimit të tejzgatur të vendosur për pasuritë e tyre. Po kështu, sipas tyre, gjykatat e zakonshme i kanë cenuar edhe të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi me mënyrën se si e kanë zgjidhur çështjen, jo vetëm nuk e kanë riparuar shkeljen e së drejtës së pronës, por as nuk u kanë kthyer përgjigje kërkuarve në këtë drejtim. Ndërsa subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuarët nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme.

24. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për urdhrin e kufizimit të pronës, çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të aksesit në gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të



garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, të lidhur me të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

25. Kërkuesit kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar atyre të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e pronës, si rrjedhojë e kufizimit të vendosur në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në tejkalim të afatit ligjor 30-ditor. Sipas tyre, ky kufizim, vazhdon *de facto* deri ditën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat nuk e kanë riparuar këtë shkelje dhe as nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuesve, i cili ishte pretendimi kryesor i tyre. Sipas kërkuesve, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar vetëm për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, duke mos u shprehur tërësisht për objektin e padisë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka marrë për bazë pretendimin e tyre se çështja kishte rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, duke vendosur mospranimin e rekursit.

26. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbushin standardet kushtetuese të arsytimit dhe se gjykata e zakonshme nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur, por nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura për çështjen. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria Vendore e Kadastrës, ka prapësuar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, ndaj pretendimet e kërkuesve lidhur me të janë të pabazuara.

27. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera se, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë. Ndërsa neni 41 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private është e garantuar (*pika 1*) dhe se prona fitohet, ndër të tjera, me blerje (*pika 2*).

28. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo

thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit përbën çështje kushtetuese (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon së drejtës së pronës, Gjykata ka pohuar se garantimi i saj përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Ajo përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 53 datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse pretendimet e kërkuesve në rekurs lidhen me të drejtën themelore



të pronës, shkak për të cilin Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, duhej të kishte garantuar aksesin substancial, duke u dhënë përgjigje në arsyetimin e vendimit të saj.

32. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se kërkuesit kanë fituar të drejtën e pronësisë për dy pasuri të paluajtshme nëpërmjet dy kontratave të shitblerjes të datës 9.9.2014, të cilat janë regjistruar në regjistrin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Disa muaj pas regjistrimit, konkretisht në datën 16.2.2015, ZVRPP-ja, Pukë ka nxjerrë urdhrin për kufizimin pa afat të pronës së kërkuesve, duke ia kaluar atyre barrën e paraqitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor për të vërtetuar pronësinë e shitësve për pasuritë e paluajtshme, me të cilët ata kishin lidhur kontratë të rregullt shitjeje, e cila ishte regjistruar nga vetë ZVRPP-ja, Pukë. Nuk rezulton që ZVRPP-ja, Pukë të ketë kryer veprime të mëtejshme dhe as që gjykatat e zakonshme të kenë vendosur ndonjë masë sigurimi të tillë, ndaj kufizimi i pronës vazhdon deri në ditën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, pra prej më shumë se 9 vjetësh.

33. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesit janë ankuar në gjykatë kundër urdhrin të kufizimit, duke kërkuar në thelb heqjen e tij. Procesi gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ka përfunduar me vendimin për rrëzimin e padisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka arsyetuar se urdhri i kufizimit, i cili përbën akt administrativ, është nxjerrë nga organi kompetent, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas procedurës së parashikuar nga ligji. Më konkretisht, regjistruesi ka vepruar sipas kompetencës që i jepte ligji i kohës së nxjerrjes së urdhrin të kufizimit, i cili kishte të bënte me verifikimin e të dhënave të akteve të regjistrimit të pasurive (neni 20, shkronja “e”, i ligjit nr. 33/2012). Po kështu, sipas gjykatës së apelit, urdhri i kufizimit është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe të dhënat e diktura nga situata faktike në kohën e nxjerrjes së tij, duke evidentuar se regjistrimi fillestar i pronës është bërë bazuar në një vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit dhe jo për njohjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë, siç kërkon neni 193 i Kodit Civil. Ndërsa për kohëzgjatjen e urdhrin të kufizimit, duke mbajtur në konsideratë ndryshimet ligjore nga koha e nxjerrjes së tij deri në

gjykimin e çështjes, gjykata e apelit ka arsyetuar se dispozitat kalimtare të ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nuk përmbajnë përcaktime për trajtimin e urdhrave të kufizimit të nxjerrra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe as afatet e tyre (*shih paragrafët 37–42 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

34. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, duke arsyetuar se në përmbajtjen e tij nuk përcaktohet asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

35. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe në kontekstin e rrethanave specifike të rastit konkret, Gjykata konstaton se kufizimi i vendosur nga ZVRPP-ja, Pukë përbën ndërhyrje në të drejtën e pronës së kërkuesve, ndërhyrje e cila referuar shkakut të kufizimit, por edhe periudhës së zgjatjes së tij prej më shumë se 9 vjetësh, prek thelbin e kësaj të drejte. Konstatimi i mungesës së titullit të pronësisë së shitësve vë në dyshim kalimin e së drejtës së pronësisë të kërkuesit, tek të cilët ZVRPP-ja, Pukë ka zhvendosur detyrimin për paraqitjen e dokumentacionit ligjor të regjistrimit fillestar të pronës nga shitësit, pikërisht të një titulli pronësie të vlefshëm për regjistrim. Në këtë kuptim, kufizimi *de facto* u mohon kërkuesve të drejtën e pronësisë, por pretendimet e tyre në këtë drejtim nuk janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Këto të fundit nuk kanë arsyetuar për pasojat që urdhri i kufizimit ka për të drejtën substanciale të pronës, duke lënë në thelb pa përgjigje pretendimin me natyrë kushtetuese të kërkuesve. Konkretisht, gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim formalist dhe ka përdorur metodën e interpretimit *strictu sensu* të dispozitave kalimtare të ligjit, në të cilat nuk përcaktohet afati i kohëzgjatjes së urdhrin të kufizimit, duke legjitimuar kufizimin e pronës së kërkuesve për 9 vjet radhazi dhe duke anashkaluar faktin që ligji i kohës së nxjerrjes së urdhrin të kufizimit (neni 59 i ligjit nr. 33/2012), por edhe ligji aktualisht në fuqi (neni 27 i ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”), parashikonin në mënyrë të shprehur se urdhri i ndalimit të veprimeve kadastrale, në çdo rast, zgjat 30 ditë kalendarike nga dita e lëshimit të tij dhe pas këtij afati ai e humbet fuqinë e tij, nëse nuk është vendosur sigurimi i padisë nga gjykata. Në këtë mënyrë, interpretimi i ngushtë i ligjit nga gjykata e



apelit ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës së kërkuesve, të cilët e kanë fituar këtë të drejtë me anë të blerjes, që mbrohet në mënyrë të shprehur nga neni 41, pika 2, i Kushtetutës. Kjo shkelje nuk rezulton të jetë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji.

36. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, e cila shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtëm të pretendimit që kufizimi pa afat i pasurisë mohonte thelbin e së drejtës së pronës së kërkuesve. Mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim aksesin substancial të kërkuesve dhe standardin kushtetues të arsyetimit të lidhur me të drejtën e pronës. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës nuk mund të reduktohet vetëm në zotërimin e titullit formal të pronësisë dhe se ajo realizohet përmes ushtrimit të tre tagrave të pronësisë, të cilat janë: (i) e drejta e posedimit të pronës; (ii) e drejta për ta gëzuar pronën, ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj; (iii) e drejta për të

disponuar pronën (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtëm të aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1702, datë 11.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
 4. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.2.2025.

Shpallur më 25.3.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

